



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË  
SENATI AKADEMIK



Nr. 858/3 prot.

Vlorë, më 27.06.2018

## VENDIM

Nr. 32, datë 27.06.2018

### PËR

### MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR TRAJNIMIN E VAZHDUESHËM TË KËRKUESVE TË RINJ NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI” VLORË

Mbështetur në shkronjën b, neni 1, nenin 38 dhe nenin 93 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.06.2018

### VENDOSI:


- Të miratojë strategjinë për trajnimin e vazhdueshëm të kërkuesve të rinj në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.
- Teksti i strategjisë gjendet bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPĒRISË


**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

**STRATEGJIA**

**PËR TRAJNIMIN E VAZHDUESHËM TË KËRKUESVE TË RINJ**


Miratuar me Vendim nr. 32, datë 27.06. 2018 të Senatit Akademik  
të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë

**KRYETARI I SENATIT**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**



## Përbajtja

1. Vizioni	1
2. Misioni	1
3. Qëllimi i strategjisë	1
4. Synimet e strategjisë	3
5. Arritje e synimeve strategjike	3
5.1. Fillimi i karrierës akademike	3
5.2. Mentorimi	4
5.3. Trajnime në edukim të vazhduar	5
5.4. Trajnime për të përmirësuar aftësitë e buta ( <i>soft skills</i> )	7
5.5. Trajnime për shkrim projektesh/grantesh kërkimore	7
5.6. Forcimi i <i>network</i> -ut akademik	8
5.7. Informim i vazhduar rreth fondeve kërkimore, mobiliteteve dhe mundësive të tjera të financimit për kërkuesit e rinj	9
5.8. Multidisiplinariteti në kërkim	10
5.9. Zhvillimi i karrierës	11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI "ISMAL QEMALI" VLORË

### SENATI AKADEMIK

#### 1. Vizioni

Rekrutimi i një stafi akademik dhe kërkimor premtues dhe mbështjetja ndaj tij për forcimin e kapaciteteve njerëzore në dobi të zhvillimit të shoqërisë në terësi.

#### 2. Misioni


Misioni ynë është krijimi dhe përhapja e dijes, si dhe krijimi i një kulture kërkimore-shkencore dhe akademike të mbështetur në parimet për kërkim dhe novacion të përgjegjshëm, si dhe në Kartën dhe Kodin Evropian për Kërkuesit, parimet e të cilave UV i ka mbështetur zyrtarisht. Si një nga universitetet më të rëndësishëm në jug të vendit, ne synojmë të:

- forcojmë pozitën tonë si universiteti më i madh në jug të vendit dhe ta vlerësojmë performancën tonë përkundrejt standardeve botërore.
- të sigurojmë një mjedis mbështetës, nxitës dhe të përgjegjshëm për potencialin njerëzor ekzistues dhe të rekrutuar rishtazi.
- t'i pajisim të diplomuarit tanë me njohuri shkencore, profesionale, si dhe me një kulturë kërkimore dhe arsimore të standardeve më të larta.
- të japim kontribut të ndjeshëm dhe domethënës në zhvillimin e rajonit dhe të vendit duke bashkërenduar mësimdhënien dhe kërkimin me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimin e vendit dhe shoqërisë në terësi.

#### 3. Qëllimi i strategjisë

Kjo strategji synon ndërtimin e kapaciteteve organizative për zhvillim dhe aftësim të vazhdueshëm të stafit, në veçanti stafit të ri, në mësimdhënie, kërkim, aftësi të buta dhe fusha të tjera që kërkojnë shprehi dhe ekspertizë të veçantë përmes një politike trajnimi të vazhdueshëm në disa drejtime.

Qëllimi i kësaj strategje është të përkufizojë dhe përcaktojë proceset, mekanizmat dhe udhëzimet që lidhen me fazat e zhvillimit të karrierës, përcaktimin e objektivave profesionale, zhvillimin profesional, zhvillimin e aftësive menaxhuese, të lidershipit etj për ndërtimin e kapaciteteve individuale dhe institucionale ne shërbim te objektivave dhe synimeve aftashkrutra dhe afatgjate te universitetit. Strategja është një dokument udhëzues në ndihmë të stafit dhe strukturave përgjegjëse për zhvillimin e karrierës për të ndjekur dhe zbatuar një qasje të efektshme ndaj praktikave të zhvillimit të burimeve njerëzore. Kjo strategji bazohet në dokumentet e mëposhtme:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE SENATI AKADEMIK

1. Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”
2. Parimet e ECC-së (*The European Charter and Code*)
3. Planin e veprimit për HR (A Human Resources Strategy for Researchers Incorporating the Charter and Code (University of Vlora “Ismail Qemali”, Albania)

### 4. Synimet strategjike

Synimet strategjike do të bazohen në këto komponente trajnues të stafit/kërkuesve të rinj:

Fillimi i karrierës akademike

Mentorimi

Trajnime në edukim të vazhduar

Trajnime për të përmirësuar aftësitë e buta (*soft skills*)

Trajnime për shkrim projektesh/grantesh kërkimore

Forcimi i *network*-ut akademik

Informim i vazhduar rrith fondeve kërkimore, mobiliteteve dhe mundësive të tjera të financimit për kërkuesit e rinj

Multidisiplinariteti në kërkim

### 5. Arritja e synimeve strategjike


#### 5.1. Fillimi i karrierës akademike (njohja me institucionin)

##### Fillimi i karrierës akademike

Fillimi i mbarë i karrierës akademike (njohja me institucionin) shihet si çelësi i ndërtimit të kapaciteve të stafit dhe të institucionit. Kjo është periudha që vendos marrëdhënet midis anëtarit të ri të stafit, anëtarëve më të vjetër dhe drejtuesit të njësisë bazë, kryesore, titullarit të institucionet dhe drejtuesve të tjerë në institucion.

##### Synimi

Krijimi i një mjesidi sa më frysmezues dhe inkurajes për të ndihmuar anëtarët e rinj të stafit të shpalosin vlerat e tyre dhe të orientohen në karrierën e tyre akademike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

**Objektivat**

Për të arritur këtë synim, UV do të mbështesë dhe inkurajojë stafin e ri:

- për një paraqitje të mirë në pozicionin e punës/rolin/kursin që do t'i caktohet.
- për të zhvilluar aftësitë, njohuritë dhe shprehitë e nevojshme për këtë rol/pozicion/kurs.
- për të vendosur marrëdhënie të mira pune me hallka të ndryshme në universitet.
- për të marrë informacionin e duhur rrëth universitetit në lidhje me strategjinë, vizionin, qëllimet, organizimin, kulturën e punës etj.
- për të kuptuar pritshmëritë që ka institucioni ndaj tyre në lidhje me përbushjen e vizionit të universitetit.
- për t'u përshtatur dhe ndjerë i mirëseardhur në universitet.

**Strategja për arritjen e tyre**

Këto objektiva do të arrihen përmes:

- Stafi i ri i punësuar në UV me kontratë gjashtëmujore/njëvjeçare do të marrë pjesë në aktivitete njohëse (për universitetin dhe organizimin e tij) që do të organizohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës.
- Stafi i ri i punësuar në UV me kontratë gjashtëmujore/njëvjeçare do të informohet përmes publikimeve informuese në faqen zyrtare të UV-së, postës elektronike, prezantimeve në Internet dhe formave të tjera të njoftimit lidhur me mundësítë e studimit/mobilitetit/trajnimit në universitet.
- Stafi i ri i punësuar në UV me kontratë gjashtëmujore/njëvjeçare merr pjesë në ligjérata, aktivitete, ditë informimi që organizohen nga Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumnit dhe Aktiviteteve Kulturore-Sportive dhe Sektori i Promovimit Akademik dhe Botimeve Shkencore, që i ndihmojnë në zhvillimin e karrierës.
- Stafi i ri i punësuar në UV me kontratë gjashtëmujore/njëvjeçare angazhohet në aktivitete të organzuara nga njësia bazë ku bën pjesë.


**Indikatorët e progresit**

- Numri i aktiviteteve njohëse të organzuara.
- Numri i publikimeve informuese.
- Postimet në faqen zyrtare të UV-së, komunikimet përmes postës elektronike, lidhje të ndryshme për thirrje/mundësi studimi/bursa etj.
- Numri i ligjératave të organzuara.
- Numri i aktiviteteve dhe ditëve informuese të organzuara.
- Numri i aktiviteteve të organzuara nga njësítë bazë ku është angazhuar stafi i ri.

**Arritjet**

- Staf i ri i trajnuar.
- Staf i ri i informuar.
- Staf i ri me i motivuar.
- Përfshirje e stafit të ri në projekte kërkimore, mobilitetë, bursa studimi etj.

**Mentorimi**



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

**Mentorimi**

Programet e mentorimit synojnë nxitjen e stafit më të vjetër dhe me përvojë kërkimore në UV për të ndihmuar, këshilluar dhe mbështetur stafin më të ri duke ndarë me ta përvojën e tyre dhe duke dhënë ndihmesën e tyre përmes njohurive dhe ekspertizës së tyre në një fushë të caktuar. Mentorimi në UV kryhet sistematikisht nga dy mentorët (konsulentët) e jashtëm të atashuar pranë Sektori të Promovimit Akademik dhe Botimeve Shkencore, por mund të kryhet edhe nga çdo anëtar tjetër me përvojë në UV.

**Synimi**

Forcimi i lidhjeve mes anëtarëve të rinj dhe të vjetër të njësive bazë dhe krijimi i një mjedisi sa më frymëzues dhe inkurajes për të zhvilluar kërkim dhe për të zhvilluar kulturën e kërkimit.

**Objektivat**

Për të arritur këtë synim, UV do të mbështesë dhe nxisë:

- forcimin e kapaciteteve kërkimore në departamente.
- forcimin e marrëdhënieve profesionale dhe personale mes kolegëve brenda kontekstit të zhvillimit të kërkimit.
- njohjen e meritave të njësive me aftësi të shkëlqyera kërkimore.

**Strategjia për arritjen e tyre**

Këto objektiva do të arrihen përmes:

- Stafi i ri i punësuar në UV me kontratë gjashtëmuajore/njëvjeçare do të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga mentorët e jashtëm në lidhje me tematika të ndryshme për çështje kërkimore apo të jetës akademike njohëse të paraplanifikuara që do të organizohen në bashkëpunim me Sektori i Promovimit Akademik dhe Botimeve Shkencore.
- Stafi me përvojë në njësitë bazë të UV-së do të programojë një plan aktivitetesh informuese për stafin më të ri për të ndarë me ta përvoja ngajeta akademike.
- Stafi i ri i punësuar në UV me kontratë gjashtëmuajore/njëvjeçare atashohet pranë stafit më të vjetër/me përvoja në njësitë bazë për të mësuar nga përvoja e tyre.


**Indikatorët e progresit**

- Numri i aktivitetave mentoruese të organizuara nga mentorët e jashtëm.
- Lloji i tematikave të këtyre aktivitetave.
- Numri i stafit pjesëmarrës në këto aktivitete.
- Numri i aktivitetave mentoruese të organizuara nga njësitë bazë.

**Arritjet**

- Staf i ri i informuar.
- Staf i ri me i motivuar.
- Rritje e besimit dhe dëshirës për të përparuar në karrierën akademike nga ana e stafit të ri.
- Staf i ri më i përfshirë në aktivitete kërkimore.

**Trajnime për edukim të vazhduar**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË<sup>1</sup>  
SENATI AKADEMIK

**Trajnime për edukim të vazhduar**

Programet e edukimit të vazhduar synojnë zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive mësimdhënëse dhe kërkimore. Programet e mësimdhënie synojnë t'i vijnë në ndihmë stafit të ri me koncepte bazë të mësimdhënieve mënyrë që ata të jenë në gjendje t'u përcjellin njohuritë studenteve mënyrë të efektshme përmes metodava më të fundit të mësimdhënieve dhe duke kontribuar kështu në nxijen e një kulture stimuluese të mësimdhënieve dhe mësimnxënieve në universitet. Programet për kërkimin synojnë forcimin e aftësive bazë të kërkimit tek kërkuesit e rinj dhe rritjen e ndërgjegjësimit për një kulturë të kërkimit.

**Synimi**

Rritja e vetëdijes për rolin që kërkuesit kanë në mjeshterin universitar, për rolin e botës akademike në têrësi dhe kontributin e saj në zhvillimin e shoqërisë në têrësi.

**Objektivat**

Për të arritur këtë synim, UV do të mbështesë dhe inkurajojë:

- krijimin e programeve të trajnimit në metodologji të mësimdhënieve.
- krijimin e programeve të trajnimit në metodologji të kërkimit dhe çështje që lidhen me kulturën e kërkimit.
- përfshirjen e stafit me përvojë që zhvillon kurse të metodologjisë së mësimdhënieve dhe metodologjisë së kërkimit që të zhvillojnë programe trajnuese për stafin më të ri.

**Strategjia për arrijet e tyre**

Këto objektiva do të arrihen përmes:


- Stafi i ri i punësuar në UV me kontrate gjashtëmujore/njëvjeçare do të marrë pjesë në programet e trajnimit në metodologji të mësimdhënieve.
- Stafi i ri i punësuar në UV me kontratë gjashtëmujore/njëvjeçare do të marrë pjesë në programet e trajnimit në metodologji të kërkimit.
- bashkëpunimit midis stafit të ri dhe stafit me përvojë për zhvillimin e këtyre trajnimeve në dobi të zhvillimit individual dhe atij institucional.

**Indikatorët e progresit**

- Numri i programeve të trajnimit në metodologji të mësimdhënieve.
- Numri i trajnimeve të organizuara në metodologji të mësimdhënieve.
- Numri i programeve të trajnimit në metodologji të kërkimit.
- Numri i trajnimeve të organizuara në metodologji të kërkimit.
- Numri i publikimeve, aktivitetave, projekteve të bashkëpunimit midis stafit të ri dhe stafit me përvojë.

**Arrijet**

- Mjeshtës më nxitës dhe mbështetës për kërkuesit dhe stafin e ri në UV.
- Staf i ri më i përgatitur për kërkim dhe mësimdhënie.
- Bashkëpunimin midis stafit të ri dhe stafit me përvojë.



**REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**SENATI AKADEMIK**

**Trajnime për të përmirësuar aftësitë e buta (*soft skills*)**

**Trajnime për të përmirësuar aftësitë e buta (*soft skills*)**

Integrimi i kërkitit në një botë globale që lëviz dhe zhvillohet me ritme marramendëse kërkon përshtatje jo vetëm në drejtim të zhvillimit dhe pajisjes me njohuri dhe aftësi ngushtësisht profesionale, por edhe me pajisjen e atyre aftësive joteknike që shpesh njihen si aftësi të buta (*soft skills*).

**Synimi**

Integrimi i suksesshëm, social dhe profesional, i kërkuesve të rinj në një mjedis të ri.

**Objektivat**

Për të arritur këtë synim, UV do të mbështesë dhe inkurajoje:

- krijimin e programeve të trajnimit për kompetencën ndërkulturore.
- krijimin e programeve të trajnimit për kompetencat komunikuese dhe menaxhuese.
- përfshirjen e stafit me përvojë në këto kompetenca që të zhvillojnë programe trajnuese për stafin më të ri.

**Strategjia për arritjen e tyre**

Këto objektiva do të arrihen përmes:

- Stafi i ri i punësuar në UV me kontrate gjashtëmujore/njëvjeçare do të marrë pjesë në programet e trajnimit për kompetencën ndërkulturore.
- Stafi i ri i punësuar në UV me kontrate gjashtëmujore/njëvjeçare do të marrë pjesë në programet e trajnimit për kompetencat komunikuese dhe menaxhuese.
- bashkëpunimit midis stafit të ri dhe stafit me përvojë për zhvillimin e këtyre trajnimeve në dobi të zhvillimit individual dhe atij institucional.

**Indikatorët e progresit**


- Numri i programeve të trajnimit për kompetencën ndërkulturore.
- Numri i trajnimeve të organizuara për kompetencën ndërkulturore.
- Numri i programeve të trajnimit për kompetencat komunikuese dhe menaxhuese.
- Numri i trajnimeve të organizuara për kompetencat komunikuese dhe menaxhuese.
- Numri i publikimeve, aktivitetave, projekteve të bashkëpunimit midis stafit të ri dhe stafit me përvojë.

**Arritjet**

- Mjedis më nxitës dhe mbështetës për kërkuesit dhe stafin e ri në UV.
- Staf i ri i pajisur me kompetencë ndërkulturore, aftësi komunikuese dhe menaxhuese.
- Bashkëpunimin midis stafit të ri dhe stafit me përvojë.

**Trajnime për shkrim projektesh/grantesh kërkimore**

**Trajnime për shkrim projektesh/grantesh kërkimore**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Këto trajnime kanë për qëllim zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve njerëzore, si dhe për të ndihmuar stafin e ri për të përgatitur projekt-propozime, raporte progresi, raporte kërkimore, dosje patentash.

**Synimi**

Zgjerimi i kapacitetit dhe produktit kërkimor përmes përfitimit të fondeve për kërkim, publikimeve prestigjioze dhe krijimit të patentave dhe në këtë mënyre, sigurimi i një impakti të gjerë dhe përbushja e arritjeve të përcaktuara në Strategjinë për Kërkimin Shkencor.

**Objektivat**

Për të arritur këtë synim, UV do të mbështhesë dhe inkurajojë:

- krijimin e programeve të trajnimit për shkrim projektesh/aplikim grantesh.
- krijimin e programeve të trajnimit për shkrim akademik.
- përfshirjen e stafit me përvojë në këto kompetenca që të zhvillojnë programe trajnuese për stafin më të ri.

**Strategja për arritjen e tyre**

Këto objektiva do të arrihen përmes:

- Stafi i ri i punësuar në UV me kontratë gjashtëmujore/njëvjeçare do të marrë pjesë në programet e trajnimit për shkrim projektesh/aplikim grantesh.
- Stafi i ri i punësuar në UV me kontratë gjashtëmujore/njëvjeçare do të marrë pjesë në programet e trajnimit për shkrim akademik.
- bashkëpunimit midis stafit të ri dhe stafit me përvojë për zhvillimin e këtyre trajnimeve në dobi të zhvillimit individual dhe atij institucional.

*Indikatorët e progresit*

- Numri i programeve të trajnimit për shkrim projektesh/aplikim grantesh.
- Numri i trajnimeve të organizuara për shkrim projektesh/aplikim grantesh.
- Numri i programeve të trajnimit për shkrim akademik.
- Numri i trajnimeve të organizuara për shkrim akademik.
- Numri i aplikimeve, projekteve të bashkëpunimit midis stafit të ri dhe stafit me përvojë.


*Arritjet*

- Mjedis më nxitës dhe mbështetës për kërkuesit dhe stafin e ri në UV.
- Staf i ri i trajnuar në shkrim projektesh.
- Bashkëpunimin midis stafit të ri dhe stafit me përvojë.

**Forcimi i *network*-ut akademik**

**Forcimi i *network*-ut akademik**

Ky komponent i strategjisë synon zhvillimin e aftësive të kërkuesve të rinj për të krijuar lidhje dhe u bërë pjesë e *network*-eve. *Network*-u është shumë i rëndësishëm për një karrierë të suksesshme në arsimin e lartë, sidomos në kushtet e ndërkombëtarëzimit të arsimit të lartë dhe nxitjes së lëvizjes së stafit akademik dhe si i tillë duhet parë me përparsësi pasi nuk është e lehtë për kërkuesit e rinj të



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**SENATI AKADEMIK**

integrohen menjëherë në *network*-un e botës akademike.

**Synimi**

Krijimi i hapësirave për zgjerimin dhe krijimin e *network*-eve si një nga mënyrat më të efektshme për nxitten e bashkëpunimeve akademike dhe profesionale dhe forcimin e kapacitetit njerëzor.

**Objektivat**

Për të arritur këtë synim, UV do të mbështesë dhe inkurajojë te gjitha iniciativat në mbështetje të kërkuesve të rind që nxisin bashkëpunimin dhe *network*-un si:

- konferenca për studentët e doktoraturës.
- sesione të posaçme në konferenca kombëtare e ndërkombëtare për kërkuesit e rind/studentët e doktoraturës.
- organizimin e *workshop*-eve dhe seminareve për kërkuesit e rind/studentët e doktoraturës.
- trajnime për zhvillimin e strategjive të *network*-ut.
- nxitten e përfshirjes në rrjete sociale akademike si Euraxess etj.

**Strategjia për arritjen e tyre**

Këto objektiva do të arrihen përmes:

- organizimit të konferencave, *workshop*-eve, seminareve për kërkuesit e rind/studentët e doktoratës.
- organizimit të sesioneve të posaçme në konferenca kombëtare e ndërkombëtare për kërkuesit e rind/studentët e doktoraturës.
- organizimit të trajnimeve për zhvillimin e strategjive të *network*-ut.

**Indikatorët e progresit**

- Numri i konferencave, *workshop*-eve, seminareve, sesioneve të organzuara për kërkuesit e rind/studentët e doktoratës.
- Numri i kërkuesve të rind/doktorantëve pjesëmarrës në këto aktivitete.
- Numri i trajnimeve te organzuara për zhvillimin e strategjive të *network*-ut.
- Numri i kërkuesve të rind/doktorantëve pjesëmarrës në këto trajnime.

**Arritjet**

- Staf i ri më i motivuar dhe më i integruar.
- Rritje e numrit të bashkëpunimeve shkencore për publikime, projekte kërkimore etj.
- Rritja e vizibilitetit dhe impaktit të UV-së në vend, rajon dhe më gjërë.

**Informim i vazhduar rreth fondeve kërkimore, mobiliteteve dhe mundësive të tjera të financimit për kërkuesit e rind**

**Informim i vazhduar rreth fondeve kërkimore, mobiliteteve dhe mundësive të tjera të financimit për kërkuesit e rind**

Ky komponent i strategjisë synon rritjen e pjesëmarrjes së kërkuesve të rind në projekte kërkimore, mobilitete dhe aktivitete të tjera kërkimore të finançuara nga organizma të ndryshme vendase dhe të huaja.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

UNIVERSITETI "ISMAL QEMALI" VLORË<sup>1</sup>  
SENATI AKADEMIK

**Synimi**

Njohje dhe informim i vazhduar në lidhje me mundësitë që ekzistojnë për kërkuesit e rind për të aplikuar për grante e fonde kërkimi, mobilitete, projekte kërkimore etj me qëllim nxitjen e përfshirjes së tyre në bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përparimin në karriere.

**Objektivat**

Për të arritur këtë synim, UV do të:

- identifikojë të gjitha mundësitë financiare brenda dhe jashtë vendit që mbështesin zhvillimin e kërkimit shkencor.
- bashkëpunojë me zyrat përkatëse të organizmave financuese dhe koordinojë me to organizimin e ditëve të informimit.
- kryejë në mënyre sistematike informimin e stafit për thirrjet e radhës së aplikimeve për grante, fonde a projekte përmes emailit, website-t të UV-së dhe faqeve zyrtare të UV-së në rrjete sociale.

**Strategja për arritjen e tyre**

Këto objektiva do të arrihen përmes:

- krijimit të një broshure informative elektronike për informimin rreth skemave financiare për kërkimin brenda dhe jashtë vendit.
- organizimit të ditëve të informimit për skema të ndryshme financiare në bashkëpunim me zyrat përkatëse kombëtare përfaqësuese të këtyre skemave apo organizmave për Shqipërinë.
- publikimit të herëpashershëm të thirrjeve të radhës për aplikime për grante/bursa etj në website-in e UV-së dhe faqet zyrtare të UV-së në rrjete sociale.
- informimit të stafit përmes postës elektronike.

**Indikatorët e progresit**

- Numri i broshurave informative elektronike rreth skemave financiare për kërkimin brenda dhe jashtë vendit të publikuara online.
- Numri i ditëve të informimit të organizuara.
- Numri i kërkuesve të rind/doktorantëve pjesëmarrës në këto aktivitete.
- Numri i shikimeve të postimeve të thirrjeve online.
- Numri i aplikimeve për bursa/grante/fonde për kërkimin nga kërkuesit e rind/doktorantët të UV-së.

**Arritjet**


- Staf i ri më i motivuar dhe më i integruar.
- Rritje e numrit të bashkëpunimeve shkencore për publikime, projekte kërkimore etj.
- Rritja e vizibilitetit dhe impaktit të UV-së në vend, rajon dhe më gjërë.

**Multidisiplinariteti në kërkim**

**Rritje e ndërgjegjësisë për çështje të multidisiplinaritetin në kërkim**

Ky komponent i strategjisë synon rritjen e ndërgjegjësimi të kërkuesve të rind për çështje të multidisiplinaritetit në kërkim, për pjesëmarrje në aktivitete shkencore me natyrë multidisiplinare etj.

**Synimi**



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

## UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Njonde dhe informim i vazhduar në lidhje me mundësítë që ekzistojnë për kerkuesit e rinj për të aplikuar për grante e fonde kërkimi për projekte kërkimore me natyrë multidisiplinare, përtu përfshie ne kerkim me natyrë të tillë etj.

### Objektivat

Për të arritur këtë synim, UV do të:

- identifikojë të gjitha mundësítë financiare brenda dhe jashtë vendit që mbështesin zhvillimin e kërkimit shkencor multidisiplinar.
- nxise kerkuesit e të katër fakulteteve të bashkërendojnë punën e tyre kërkimore drejt kërkimit multidisiplinar që ngërthen ekspertiza të ndryshme e cilësore drejt një produkti kërkimor të denjë.
- bashkëpunojë me sektorët përkatës në UV, si dhe zyrat përkatëse të organizmave financuese dhe koordinojë me to organizimin e ditëve të informimit.
- kryejë në mënyre sistematike informimin e stafit për thirrjet e radhës së aplikimeve për grante, fonde a projekte përmes emailit, website-t të UV-së dhe faqeve zyrtare të UV-së në rrjete sociale.

### Strategjia për arritjen e tyre

Këto objektiva do të arrihen përmes:

- pjesëmarrjes se kerkuesve të UV në veprimtari multidisiplinare, projekte kërkimore multidisiplinare etj.
- rritjes së ndergjegjësimit përmes organizimit të ditëve të informimit për skema të ndryshme financiare në bashkëpunim me zyrat përkatëse kombëtare përfaqësuese të këtyre skemave apo organizmave për Shqipërinë si Horizon2020 etj.
- nxitjen e stafit përtu bërë pjesë e rrjetit Euraxess.
- publikimit të herëpashtershëm të thirrjeve të radhës për aplikime për grante/bursa etj në website-in e UV-së dhe faqet zyrtare të UV-së në rrjete sociale.
- informimit të stafit përmes postës elektronike.

### Indikatorët e progresit


- Numri i ditëve të informimit të organizuara.
- Numri i kerkuesve të rinj/doktorantëve pjesëmarrës në këto aktivitete.
- Numri i shikimeve të postimeve të thirrjeve online.
- Numri i aplikimeve për bursa/grante/fonde për kërkimin nga kerkuesit e rinj/doktorantët të UV-së.

### Arrijet

- Staf i ri më i motivuar dhe më i integruar.
- Rritje e numrit të bashkëpunimeve shkencore për publikime, projekte kërkimore etj.
- Rritja e vizibilitetit dhe impaktit të UV-së në vend, rajon dhe më gjërë.

## 5.9. Zhvillimi i karrierës

### Zhvillimi i karrierës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Ky komponent i strategjisë synon zhvillimin e karrierës akademike të kërkuesve të rinj duke përdorur të gjitha mekanizmat e mundshme për të rritur për pjesëmarrjen në aktivitete shkencore etj.

**Synimi**

Njohje dhe informim i vazhduar në lidhje me mundësitë që ekzistojnë për kërkuesit e rinj për të aplikuar për grante e fonde kërkimi për projekte kërkimore me natyrë multidisiplinare, për t'u përfshi ne kerkim me natyrë të tillë etj.

**Objektivat**

Zhvillimi i karrierës së studentëve dhe kërkuesve në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë nxitet, bashkërendohet dhe sigurohet përmes aktivitetit të Sektorit të Këshillimit të Karrierës, ALUMNI-it dhe Aktiviteteve Kulturore-Sportive dhe Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik.

Për të arritur këtë synim, UV do të:

- identifikojë të gjitha mundësitë financiare brenda dhe jashtë vendit që mbështesin zhvillimin e kërkimit shkencor multidisiplinar;
- nxise kërkuesit e të katër fakulteteve të bashkërendojnë punën e tyre kërkimore drejt kërkimit multidisiplinar që ngërthen ekspertiza të ndryshme e cilësore drejt një produkti kërkimor të denjë.
- bashkëpunojë me sektorët përkatës në UV, si dhe zyrat përkatëse të organizmave financuese dhe koordinojë me to organizimin e ditëve të informimit.
- kryejë në mënyre sistematike informimin e stafit për thirrjet e radhës së aplikimeve për grante, fonde a projekte përmes emailit, *website*-t të UV-së dhe faqeve zyrtare të UV-së në rrjete sociale.
- 3. Në funksion të zhvillimit të karrierës së studentëve dhe kërkuesve, Sektori i Këshillimit të Karrierës, ALUMNI-it dhe Aktiviteteve Kulturore-sportive:
  - a. përgatit publikime informuese, prezantime në Internet dhe forma të tjera njoftimi lidhur me mundësitë e studimit në universitet për studentët potencialë;
  - b. realizon kontakte me shërbime kompetente të punësimit, grumbullon dhe publikon informacion për mundësitë e punësimit të studentëve;
  - c. krijon bazë të unifikuar të dhënat për studentët e diplomuar në universitet, të cilët punojnë brenda apo jashtë vendit;
  - d. mbledh dhe publikon informacione mbi mundësitë e bursave dhe kreditimit të studentëve;
  - e. organizon takime të punëdhënësve potencialë me studentët dhe kërkuesit;
  - f. përgatit dhe zhvillon ligjérata me anë të të cilave studentët apo kërkuesit fitojnë njohuri dhe shprehi që i ndihmojnë në zhvillimin e karrierës;
  - g. këshillon studentët dhe kërkuesit lidhur me çështjet e zhvillimit të karrierës;
  - h. bashkëpunon me institucionet e tjera në fushën e zhvillimit të karrierës.
- i. organizon ditë të informimit për të njohur kërkuesit e rinj me parimet e Kodit dhe Kartës Evropiane të Kërkuesve.
- 4. Në funksion të zhvillimit të karrierës së studentëve dhe kërkuesve, Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik:
  - a. koordinon shërbime dhe aktivitete për zhvillimin e karrierës së kërkuesve të rinj dhe doktorantëve.
  - b. promovon aktivitetet kërkimore-shkencore në universitet.
  - c. organizon/koordinon trajnime në lidhje me aspekte të ndryshme të kërkimit si konfidencialiteti i të dhënavë, çështje të etikës në kërkim, bërja publike e rezultateve të kërkimit etj.
  - d. ndihmon në veprimtarinë e tij Këshillin e Etikës përmes informimit dhe trajnimeve dhe aspekte të tjera të përcaktuar në Rregulloren e Etikës në Kërkim ...
  - e. krijon dhe ndjek një strategji për komunikimin e rezultateve të kërkimit tek publiku i gjerë dhe për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

- vendosjen e një bashkëpunimi sistematik me komunitetin për shfrytëzimin e rezultateve të kërkimit.
- f. informon mbi projekte dhe grante për kërkimin shkencor të finançuar nga Bashkimi Evropian, organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit.
  - g. koordinon aktivitete trajnuese për shkrimin e projekteve kërkimore.
  - h. koordinon aktivitete trajnuese për botimet open access dhe shfrytëzimin e depozitorëve të botimeve falas.
  - i. administron databazën e botimeve shkencore.
  - j. ndjek dhe zbaton strategjinë për kërkimin e vazduar të kerkuesve.

**Strategjia për arritjen e tyre**

Këto objektiva do të arrihen përmes:

- pjesëmarrjes se kerkuesve të UV në veprimtari kërkimore-shkencore, projekte kërkimore etj.
- botimeve të realizuara.
- rritjes së ndergjegjësimit përmes ditëve të informimit.
- nxitjen e stafit për t'u bërë pjesë e rrjeteve të ndryshme shkencore-kërkimore.
- informimit të stafit përmes postës elektronike.

*Indikatorët e progresit*

- Numri i aktivitetave të organizuara.
- Numri i kerkuesve të rinj/doktorantëve pjesëmarrës në këto aktivitete.
- Numri i prezantimeve në konferenca.
- Numri i botimeve.
- Numri i aplikimeve të fituara.

*Arritjet*

- Staf i ri më i motivuar dhe më i integruar.
- Rritje e numrit të bashkëpunimeve shkencore për publikime, projekte kërkimore etj.
- Rritja e vizibilitetit dhe impaktit të UV-së në vend, rajon dhe më gjërë.

